



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE - SHKUP
ALBANISCHES INSTITUT - ST. GALLEN

EQREM BEJ VLORA

Librin BISEDIME MBI "HISTORIN BUJQËSORE TË SHQIPNIS" që po sjellim për botim, paraqet vlerat e mendimit intelektual shqiptar mbi problematika që ishin më pak të trajtuara në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, siç ishte, bie fjala, çështja e tokës dhe sidomos menaxhimi i saj në pikëpamje agroteknike. Autori i këtij libri, Eqrem Bej Vlora, na sjell fakte të panjohura mbi historinë e tokës bujqësore në Shqipëri dhe sidomos mangësitë që janë shfaqur në të kaluarën sa i përket mirëmbajtjes së saj, ku spikat sidomos sistemi i kullimit dhe shkarkimit të ujërave, si një nga faktorët kryesor që kanë ndikuar në degradimin e tokës së bukës.

Autori Ekrem Vlora, duke i quajtur pikëpamjet e tij BISEDIME, i ka bërë një analizë të thuktë gjendjes së tokës bujqësore, sidomos në pjesën bregdetare të saj. Sipas tij ka qenë faktori njeri dhe moskujdesi shtetëror, shkaktarët kryesorë që kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes gjeomorfologjike të tokës bujqësore. Prandaj ai me të drejtë që në fillim e thotë motivin dhe dedikimin e këtij libri: "KETO BISEDIMET JA U KAM KUSHTUE GJITH ATYNE NE SHQIPNI QE TUE KERKUE PERHERE MA TË MIRËN E PERSOSUN KAN LANE MBAS DORE TË MIREN E THJESHTE".

**BISEDIME MBI "HISTORIN
BUJQËSORE TË SHQIPNIS"**

BISEDIME MBI "HISTORIN BUJQËSORE TË SHQIPNIS"


Përgatitën për botim:

**Albert RAMAJ
Skender ASANI**

EQREM BEJ VLORA



Shkup, 2021



INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE
- SHKUP
ALBANISCHES INSTITUT - ST. GALLEN

Eqrem bej Vlora

BISEDIME MBI “HISTORIN BUJQËSORE TË SHQIPNIS”

Përgatitën për botim:
Albert RAMAJ
Skender ASANI



albanisches
institut

Shkup, 2021

Botues:
Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve–Shkup
Albanisches Institut - St. Gallen

Eqrem bej Vlora
BISEDIME MBI “HISTORIN BUJQËSORE TË SHQIPNIS”

Përgatitën për botim:
Albert RAMAJ
Skender ASANI

Recensentë:
Bejtullah Destani
Zef Ahmeti
Sevdail Demiri

ISBN: 978-608-4897-49-1

www.itsh.edu.mk
www.albanisches-institut.ch

Të drejtat autoriale Copyright© janë të rezervuara për botuesit

Ky botim financohet nga:



Eqrem bej Vlora
BISEDIME MBI "HISTORIN BUJQËSORE TË SHQIPNIS"

Përgatitën për botim:
Albert RAMAJ
Skender ASANI



Eqrem bej Vlora
(Vlorë, 1885 – Vjenë, 1964)

PËRMBAJTJA

HYRJE.....	7
(MANUSKRIFTI I SHTYPUR SIPAS ORIGJINALIT)	11
KAPT. I. PËRSHKRIM I FUSHËS BREGDETARE TË SHQIPNIS	17
KAPT. II-të HISORIA BUJQËSORE E FUSHËS BREGDETARE TË SHQIPNIS	21
Perioda e I-rë – Koha e lashtë prej 16- para Kr. – 1250 Kr.....	21
Perioda e II-të – Koha e mesme 1250 pas Kr. deri më 1835.....	24
Perioda e III-të. – Koha e re, prej 1835 deri më 1912	47
KAPT. III-të ORIGJINI DHE HISTORIJA E DISA PASUNIVET TOKSORE NE SHQIPNI.....	61
BUSHATLLIT (Shkodër).....	62
TOPTANASIT (Tiranë).....	64
Libohova (Sqyfteri).....	65
Asslan Pashalli JANINE	65
DELVINA (MUSTAF AGARAJ) Delvinë - Tiranë	66
ALIZOT (KUKA) Gjinokastër –Tiranë	67
VRIONET (Berat – Fier)	68
VLORA (Sinanaj) (Gjeigju) Vlonë.....	70
SKEN NJESHI DUHET VENDOSUR.....	71
KOKATET (Koka) Delvine-Tirane	74
GJENDJA E SOTME E BUJQESIS	75
KAPT. E IV-të MJETET PER TA PERMIRESUE	97
KAPT. E V-të PERFUNDIM - NJI SHIKIM MBI TË ARDHMEN	125
(FAKSIMILE NGA MANUSKRIFTI ORIGJINAL)	133

NË VEND TË HYRJES

(si dhe rruga e dorëshkrimit deri te botimi)

Librin BISEDIME MBI “HISTORIN BUJQËSORE TË SHQIPNIS” që po sjellim për botim, paraqet vlerat e mendimit intelektual shqiptar mbi problematika që ishin më pak të trajtuara në gjysmën e parë të shekullit të kaluar, siç ishte, bie fjala, çështja e tokës dhe sidomos menaxhimi i saj në pikëpamje agroteknike. Autori i këtij libri, Eqrem Bej Vlora, na sjell fakte të panjohura mbi historinë e tokës bujqësore në Shqipëri dhe sidomos mangësitë që janë shfaqur në të kaluarën sa i përket mirëmbajtjes së saj, ku spikat sidomos sistemi i kullimit dhe shkarkimit të ujërave, si një nga faktorët kryesor që kanë ndikuar në degradimin e tokës së bukës.

Autori Ekrem Vlora, duke i quajtur pikëpmajete e tij BISEDIME, i ka bërë një analizë të thuktë gjendjes së tokës bujqësore, sidomos në pjesën bregdetare të saj. Sipas tij ka qenë faktori njeri dhe moskujdesi shtetëror, shkaktarët kryesorë që kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes gjeomorfologjike të tokës bujqësore. Prandaj ai me të drejtë që në fillim e thotë motivin dhe dedikimin e këtij libri: “KETO BISEDIMET JA U KAM KUSHTUE GJITH ATYNE NE SHQIPNI QE TUE KERKUE PERHERE MA TË MIRËN E PERSOSUN KAN LANE MBAS DORE TË MIREN E THJESHTE”.

Libri hapet me një letër që autori, Eqrem Bej Vlora, i drejtohet Ministrit t’Ekonomis Kombëtare, në të cilën ai shfaq një varg mendimesh e sygjërimesh mbi nevojat, mundësitë dhe mënyrat e aplikimit të “një reforme agrare në Shqipni”. Duke e pa të arsyeshme që ta informojë ministrin më detajisht “mbi hitorinë bujqësore të Shqipnis gjatë shumë shekujsh edhe veçanërisht mbi gjëndjen e sotme bujqësore”, autori jep disa të dhëna të vlefshme mbi potencialin hapësinor të tokës bujqësore përgjatë bregdetit. Sipas tij vija bregdetare, nga Vlora deri në Shkodër, nuk mund të jetë edhe për shumë vjet akoma, një “hambar i begatisë bujqësore”, siç pretendojnë shumica e shqiptarëve. Këtë mendim ai e mbështet në faktin se se këto janë toka “të mbushura” ase “të sjelluna”, relativisht të reja, të

fituara nga tharja e kënetave. Në formimin e këtyre tokave kanë ndikuar edhe prurjet e lumejve dhe prrojet e maleve, me një veprimtari të ngadaltë, por mijvjeçare, buzë detit dhe kënetave.

Autori duke qenë kritik ndaj autoriteteve vendore që nuk kishin arritur ta menaxhojnë si duhet tokën bujqësore, në njërën e merr si të mirëqenë thënien e autorëve të ndryshëm në kohën e romakëve se “Myzeqeja paska qenë *Hambari i Romës*, ndonëse sipas tij “zhvillimi mijvjeçarë ka ndryshue krejt situatën. Ky ndryshim kuptohet vetëm po të marrim parasysh se buza e detit të sotmë ishte 10-15 km ma përbrenda tokës”.

Për ta ilustruar mendimin e tij se sa e zhvilluar ka qenë bujqësia në kohët e mëhershme, autori flet për një zonë të pasur me qytete të lulëzuara si: Orikum (Pasha Limani), Billis (Ballshi), Amathia (Ploca), Apollonija (Pojani), që kanë pasun një kulturë të lartë, e një bujqësi intensive.

Libri BISEDIME MBI ‘HISTORIN BUJQËSORE TË SHQIPNIS’ është i ndarë në pesë kapituj dhe është i pajisur me të dhëna bibliografike e faktografike që e bëjnë këtë botim të jetë një burim relevant për të gjithë ata që do të merren me studime më të thelluara mbi këtë problematikë. Ndarja në kapituj i ka ndihmuar autorit që në librin e tij të paraqesë zhvillimin kronologjik të historisë së tokës bujqësore në Shqipëri, që nga antika e deri në kohën kur ai e shkruan këtë vepër.

Në vitin 1998 Albert Ramaj kishte vizituar gruan e Krist Malokit, zonjë Freya Maloki, në Graz në banesën e saj private. Gjatë bisedimeve zonja Maloki i tregon se në biblitekën e Krist Malokit gjindet një manuskript me titull “Bisedime mbi ‘Historin bujqësore të Shqipnis’” i Ekrem bej Vlorës të cilin ia kishte dhënë Krist Malokit. Vlorë e Maloki kishin një miqësi të mirë. Këtë manuskript ia dhuron zonja Freya Maloki Albertit me kusht që të botohet! Një tentim për përgatitjen për botim të këtij manuskripti ishte i kahmotshëm, por realizimi po bëhet tani nga ana e ITShKSh në Shkup dhe Institutit Shqiptar (Albanisches Institut) në St. Galen.

Pas disa kontakteve që Bejtullah Destani na i dha me familjarët e Ekrem bej Vlorës, komunikuam për këtë mundësi të botimit të këtij manuskripti. Komunikuam me stërnipin e E. Vlorës, Darling Vlorë e që më 25.10.2015 i shkruajti Albertit këto fjalë për këtë manuskript:

“Sinqerisht me dha mjaft kënaqësi fakti që ky punim i Ekrem bej Vlorës gjendet në duart tuaja. Sipas informacioneve të mia e kam ditur ekzistencën e këtij punimi mbetur në doreshkrim, por jo fatin që kishte patur. Pra nëse

ekzistonte akoma apo kishte humbur përgjithmonë. Me aq sa di Eqrem beu duhet ta ketë shkruar rreth vitit 1941/42, por nuk e botoj dot. Me pas ai u largua dhe dorëshkrimi mbeti, por shqyr Zotit nuk paska humbur.... Me z. Destani bisedova diçka rreth dorëshkrimit që ke. Nuk e di si e ke menduar por nëse është shkruar në gjuhën shqipe do isha i mendimit që ajo të përdorej siç është shkruar nga vetë Eqrem beu, pa u redaktuar. Kjo për arsye sepse është i pari libër i tij i shkruar drejt e në gjuhën shqipe, pasi librat e tjerë janë shkruar në gjermanisht e me pas përkthyer në shqip. Kjo do përbënte një veçanti pasi kështu kemi drejt gjuhën e tij në shqip dhe besoj se shqipja e tij është mjaft e pasur dhe e bukur, pasi unë kam patur edhe fatin të lexoj disa dorëshkrime të tij."...

Poashtu më 09.11.2015, Darling Vlora i shkruan edhe një herë Albert Ramajt: "Këto ditë kam folur sërish në telefon. Sigurisht edhe për ata është mjaft kënaqesi që dorëshkrimi i Eqrem beut të shohë dritën e botimit. Ndërkohë nipi i tij, djali i Ainishahut (vajza e Eqrem beut) që banon në Vlorë bashkë me nënën, këtë javë ose maksimumi javën që vjen, do bëjë një udhtim në Milano dhe shprehu dëshirën, nëse për ty është e mundur, që të takohemi bashkë në Milano."

Të njëjtën kohë kishim kontaktuar edhe Tanush Frashërin për këtë manuskript, i cili i shkruante më 23.10.2015 Albertit këtë sqarim rreth dorëshkrimit në fjalë: "Bashkeshortja ime, që është mbesa e Eqrem Vlorës, e vellajt të tij, ju falenderon për përpjekjet që keni bërë për ta gjetur dorëshkrimin dhe që po e botoni; mer përsiper t'ju autorizojë botimin dhe ju shkarkon nga përgjegjësia e ju eviton kontakt me trashëgimtarin. Suksese në punën tuaj."

ITShKSh dhe AI me këtë libër po pasurojnë fondin botues dhe po e zgjerojnë atë me edicione që drejtpërdrejt apo tërthorazi ndërlidhen me historinë dhe zhvillimin e pasurive tona natyrore. E veçanta e këtij botimi është se ai po vjen për herë të parë para lexuesit, në një version krej autentik dhe me një gjuhë që ishte në përdorim në kohën kur u shkrua, pra në gjysmën e parë të shekullit të kaluar.

Albert Ramaj & Skender Asani

Shkup - St.Gallen, dhjetor 2021

***(MANUSKRIPTI I SHËTYPËR
SIPAS ORIGINELIT)***

Zoti Ministër,

Nga këmbimi i mendimevet që pata me Zotninë e Juej, mbi nevojat, mundësitë dhe mënyrat e aplikimit të "nji reforme agrare" në Shqipni, mora guximin me Ju parashtrue bisedimet që vijnë:

E pashë të nevojshme, ma parë se të hyjë në thelbin e çështjes, të jap disa shkoqitje mbi tokën që asht objekti i këtij studimi, mbi hitorinë bujqësore të Shqipnis gjatë shumë shekujsh edhe veçanërisht mbi gjëndjen e sotme bujqësore.

U largova ndofta tepër nga tema që ka qenë objekti i bisedimit me z. Tuej edhe për këtë ju kërkoj ndjesë! Por desha, qëllimisht, këtë studim t'a zgjanoj, tue përmbledhë një herë e mirë të gjitha rrethanat e problemit agrar të vëndit tonë. E di që këto tregime të mija nuk jan të panjoftuna nga shumica e njerëzve që mirren me punë këso-dore, nuk kam zbulue pra ndonji gja të re!

E pash vetëm të nevojshme t'a plotsoj këtë studim, tue tregue të gjitha shkaqet që e detyruën bujqsin shqiptare, të jetë, sikundër se asht sot! Desha veçanërisht, të provoj, që shtrëngata e disa fuqive, që janë përmbi dëshirat dhe vullnetet njerëzore, e kanë shkaktue këtë gjëndje të mjerueshme. Janë pra të gabuëm ata që kujtojnë se ky mjerim, në të cilin lëngon bujqësia shqiptare, mvaret nga vullneti i keq, ase nga mos-kujdesja e personave dhe klasavet. Desha t'i ap fund, një herë e mirë, besimit që mbretnon në Shqipni, se gjoja kjo gjëndje mund të gjejë shërim, lehtësisht dhe me të shpejtë, me raporte theorike, me fjalë të kota as me riceta demagogjike, edhe sidomos me shgatrrimin e gjëndjes toksore të sotme.

Qëllimi i im asht, që të ndalohet së paku këtë herë që po i qasemi zgjidhjes së këtij problemi kryesorë për vëndin tonë, ndërhyrja e influencës së keqkuptimit, të qëllimit dhe të nevojës, në zgjidhjen e problemit bujqësor.

Duhet pa dyshim një "reformë" për përmirësimin e bujqësis, por duhet një reformë që të përfshijë shërimin e gjithë problemit agrar! Vetëm se, aplikimi i kësaj "reformë" nuk duhet të merret nëpër këmbë, si asht bamë deri sot, me një thjeshtësi foshnjore edhe nën shtytjen e rrymave demagogjike. Duhet të kujtojmë, që gjendja bujqësore e një vëndi asht pasqyra e shkallës së qytetnimit të përgjithshëm t'atij vëndi. Zhvillimi bujqësor mvaret dhe lidhet: me ngjarjet shekullore të vëndit dhe të popullit,

nga shkalla e kulturës së tij, dhe nga zhvillimi i tij shpirtnuer, landor, politik dhe demografik.

Nuk përdor data, statistika, si dhe harta të shumta, që ndofta do kishin lehtësuar kuptimin e kësaj bisedës ma mirë, mbasi jam i bindun se, askush ma tepër se ajo Ministri, nuk mund t'i dijë e t'i ketë këto në dispozitën e vet.

Kam bindjen e plotë, Zoti Ministër, se, aplikimi i një reforme agrare të dobishme për popullin shqiptar e për interesin e ekonomisë dhe të politikës së vendit, nuk mvaret aqë nga shpejtësija e aplikimit t'sajë, sa nga thellimi i studimit të këtij problem, si edhe nga pregatitja e themelleve të shëndosha paraprake për këtë reformë.

Lejohem të shpresoj, Zoti Ministër, që ndërmjet këtyne fletëve të gjeni dishka, që mund të Ju shërbejë për këtë qëllim.

Në se do të ja arrij këtij qëllimi, kjo gja do të jetë për mua shpërblimi ma i çmueshem për mundimin tim.

Pranoni me këtë rast, Ju lutem, nderimet e mija ma të çqueme.

Mis'i Institutit Shqiptar
për Studime dhe Arte
(EKREM VLORA)

Tiranë, më 30. VI. 1944

Shkëlqesis së Tij
Zotit Ministër t'Ekonomis Kombtare

- Stervite pamjen me shikime t'gjana!
Vetso, po munde, ret'gjellit, kurse shkasin
Nga lindja në perëndim, nga jugu në verri!
Por tue shikue hapsinat, nalt, yënore,
Mos u harro me pamjet sall'madhshtore,
Sa mos të shofish këtë tokën –
Qe lulzon nën' kamb't e tua!
(A. Wildgans)

KETO BISEDIMET
JA U KAM KUSHTUE GJITH ATYNE NE SHQIPNI
QE TUE KERKUE PERHERE
MA TË MIRËN E PERSOSUN
KAN LANE MBAS DORE
TË MIREN E THJESHTE

KAPT. I.

PËRSHKRIM I FUSHËS BREGDETARE TË SHQIPNIS

Toka e një vendi asht dhurata përfudimtare e zhvillimit gjeologjik mijvjecarë.

Shqipnija nuk ka qenë, për sa i përket tokës sajë bujqësore, nga e cila tokë ajo pret bukën e sotme edhe begatin e ardhëshme, shumë e lumtun!

Buza e detit, që nga Vlona deri në Shkodër, me një gjansi që luen ndërmjet 20-60km, nuk asht, e nuk mund të jetë edhe për shumë vjet akoma, një “hambar i begatisë bujqësore” sikudër se kujton shumica e shqiptarvet.

Dikush mundet e ndofta, të çudit që unë e kam kufizuar tokën bujqësore shqiptare vetëm me këtë fushë! Ka, pa dyshim, fusha të tjera Shqipnija! Këto, në mos janë ma të gjana, sigurisht janë ma pjellore dhe bujqësia e tyre asht ma e zhvillueme. Fushat e Kosovës, të Dibrës, të Tetovës, të Gjinokastrës dhe ajo e Vurkut të Delvinës, janë fusha bujqësore të dorës së parë, kanë ujë për t’i vaditur, kanë godinat bujqësore më të mirat që ndodhen në Shqipni. Por shumzimi i popullatës në këto vise ka shkaktue vetvetiu pjestimin e tokës, deri më një shkallë, saqë nuk mund të zihen në gojë, përse i përket “reformës agrare”, me kuptimin e pjesëtimit të tokës, (mbasi mjerisht vetëm kjo trajta e reformës agrare ka gjetur pëlqim në qarqet shqiptare)!

Edhe un nuk desha të shkoj kundra rrymës së përgjithëshme, prandaj po kufizohem në studimin e fushave të bregdetit, tue përjashtue të gjitha fushat e tjera të Shqipnis.

Të huajt, shumë herë na e kanë përshknue këtë fushë si një “Misir i ardhshëm”, plot mundësina zhvillimi, dhe e kanë lakmue edhe kur kanë mundun, kanë vumë dorë mbi ndonji copë të sajë! Por mua më duket se ata, me dashje a pa dashje, nuk kanë marrë parasysh shpenzimet që kanë bamë për shfrytëzimin e kësaj toke nga pikpamja ekonomike, tregtare, mbasi kanë veprue vetëm me qëllime politike.

probleme bujqore. Bujqit "që quhen të shkelun", jo vetëm që nuk muërën pjesë në këto lëvizje por kur erdhi rasti edhe i kundërshtuën.

Mund të thuhet se ishin shtytun prej pronarvet? Jo as pak! Se dikush prej këtyne pronarvet për me mos mbet rrymës së përgjithshme dhe me shpresë se do të shpëtojnë nga konsekuencat e saja, (shqiptari kujton përherë se ç'do e keqe mund t'i ngjajë shokut, se asht "budall", kurse ati vetë nuk mund t'i takoj veç se e mira se asht "i quët"), asht edhe bashkuë me këto lëvizje!

E vërteta asht se bujku nuk donte e nuk do të komprometoj atë mirëqenien e tij relative se asht nënshtetas i bindun, element krujë, i stërvitun me kujtimin e detyravit të tija. Asht i vetmi element në Shqipni që i stërvitun nga provat e jetës ka përgatitjen dhe respektin e punës, pranon udhëheqjen dhe ka bazat e nevojshme për me u ba i drejtue me dashamirsi, me kujdes, me dijeni, me vendimtarin të drejtë e të fortë, shtylla kryesore e jetës ekonomike të popullit shqiptar. Edhe për atë ç'do sakrific e banum prej shtetit edhe prej pronarit me qëllim përmirësimi të situatës tija asht e meritueshme dhe asht detyrë e shenjt!

Nuk fola në bisedimet e kalueme për organizatat bujqore të huëja në vendin tonë. Nuk asht në kompetencën t'ime të çfaq mendim mbi krijimin e tyre, mbi mënyrën e vazhdimin të punimit dhe drejtimit, që mundet qarqet kompetente të dëshirojnë me i dhanë pas kësaj, ktyne organizatave bujqore.

Me gjithë këtë, një gjë duhet të kujtoj: veprimet e E.I.A-s kanë kushtue shumë, shumë miljona të shpenzueme me kritere shkencore, në mos me kritere ekonomike. Veprat e krujueme janë madhështore, janë pa dyshim për vendin, për bujqsin dhe për ekonomin Shqiptare të dobishme, sidomos si për model t'asaj gjendjes bujqore që androjmë t'a realizojmë ndonji ditë. I bani kush i bani, nuk na intereson! Sot që gjenden në dorën e shtetit Shqiptar asht detya jonë ma e shenjtë t'i ruëjm e t'i vazhdojmë në punimet. Pesë a gjashtë mij kuintal të E.I.A.A-s nuk e shpëtojnë Shqipnin nga mundimet e sigurimit të bukës, e di, por sot dy e nesër pesë, ferma modele si E.I.A.A. do na shpëtojnë ndonji ditë nga barra e importit të drithit nga jashtë. Mos të gabohemi me reklama dhe me ideologjina demagogjike, tue pjesëtue këto azjenda që janë organizue për produktimin me sasina të mëdhaja, në prona bujqësore të vogla, ase tue i lanë në heshtje të grabiten nga pronarët e vegjël që gjinden rreth e rrotull. Ky coptimi nuk do të japi nesër asnjë kontribut të dukshëm për nevojat e përgjithshme. Krijimi i një

azjendës si E.I.A.A nevojit shumë kohë e kushton shumë mundime krahas dhe dijeni. Shteti në çdo regjim që të hyjë nesër, do të ketë nevojë për të tilla azjenda, në dashtë le t'i quëj "çifliqe", në dashtë "azjenda", në dashtë "koloze"! vetë nuk mund t'i krijojë para 10-15 vjetvet. Prandaj duhet t'i ruejm e duhet t'i punojmë. Mirë! Po me se?

Pikërisht me rinin që duhet të mblidhet dhe të organizohet për punimin e detyrueshëm, sikurse e thamë ma nalt! Dhe këtu mbarojmë propozimet e mija për një plan përmirësimi pesë-vjeçar të bujqsis s'one. Ky plan nuk asht tjetër gja veçse pjesa përgatitore e një planit ma të gjanë që mundet të zhvillohet mbas pesë vjetve.

Qëllimisht e kufizova projektin e përmirësimeve që paraqita këtu. Shumica ndofta e kënduesve të këtyne bisedimeve do mos t'a pëlqejnë këtë kufizimin. Mundet t'a quajn edhe një konservatorizëm prapanik! S'prish punë! Punën e prish përherë teprimi! Unë kam marrë tmerin nga projektet "përmirësuese të botës" me fjalë bombastike dhe me proponime "sa mali" që ma së fundmi "pjellin një mi"!

Prandaj u mundova të kufizohem. Druëj se prap, jo sa desha! shpresoj dhe uroj që në pesë vjet të plotsohen në favor të bujqsis shqiptare, këto përmirësimet që shenova. Do jenë plotësisht të mjaftueshëm, shpresoj dhe uroj, që ngjarjet dhe koha të ma lejojnë këtë fillimin!

Nuk dimë se çfarë do të na bjerë e ardhmja! Bota nuk drejtohet ma prej arësyes, por i shtrohet ngjarjeve të papritura. Mundet, që këto ngjarje, t'a zhdukën përdhunisht objektin e kësaj bisede. Mund të përmbysin gjithë ato parimet e drejtësis dhe të veçunis njerzore që kanë drejtue deri tash kuptimin dhe qëllimin e jetës s'onë. Mund të ngjajnë gjana që janë jashtë vullnetit dhe fuqivet t'ona dhe që nuk lejojnë ma arsyeime e nuk pranojnë gjykime me anë të logjikës. Në se ngjan kjo përmbysja, do të jetë një fatkeqsi për gjithë popullin shqiptar e do të ketë pasoja të tmerrëshme. Do shkaktojë rrënimet të përherëshme në dam të përgjithshëm dhe pa një dobi për kërkënd!

Uroj që nga këto ngjarje të na ruëj Zoti. Uroj që me një Shqipni etnikisht dhe ekonomikisht të bashkueme, dëshirat e krahut të vllaznohen me të drejtat e kapitalit për me sigurue nevojat e bukës të vendit t'onë dhe uroj që ky problem të zgjidhet me kënaqsin e përgjithëshme. Por, në rrethanat edhe ma të mbara, uroj që të mbretnojë mbi gjithë pasojat në Shqipni arsyeja dhe masa në çdo veprim! Mëkambja ekonomike e një vendit, të varfën e të pazhvilluëm, si asht ky i jonë, nuk duron tronditje, nuk duron shtrëngata


ase shpejtime. Mos të harrojmë se kanë qenë pikërisht nevojat ekonomike që kemi pasun, e që kanë rrjedhur nga padija e jonë, nga dëshira e shpejtimit të zhvillimit tonë, nga megalomanija e jonë, që na kanë shkatërrue shpirtërisht dhe na kanë varfëruar materialisht. Dhe më së fundi, i kanë pregadidë e i kanë çelë rrugën hymjes së të huëjvet! Por këta, dihet, nuk vijnë pse i duën fort shqiptarët dhe nuk gabohen dot ma prej mendjehollsis s'one në interesat e tyre. Mos t'bjën me të tilla gabime prap populli shqiptar, në atë pikë sa që të thotë "kemi qenë mirë, kur kemi qenë keq".

Burimi i jonë, i pakët ase i shumë, ai do që të asht, duhet të mjaftojë për nevojat tona. Se këto nevojat nuk i dikton "dëshira", por i dikton "mundësia" e jonë. Shpresat, llogarit, të mbështetuna në mëshirën ase në nevojën e botës, për neve kanë dalë dhe do dalin përherë të rrema. Prej vet-vedit duhet të kërkojë pupulli shqiptar të shërojë pas kësaj plagët që rrethanat e kaluëme i kan shkaktue. Në do t'a fitoj a t'a ruëj të drejtën që të rroj i pavarun nga fqinj e tij, duhet ma para të japi provat e zotnisë tija në këtë pamvarsin e veprës paqsore, ekonomike, përparimtare. Me punën e tij, me ndershmërin reale, duhet t'i vejë masën kësaj liris e të rregulloj, dalë nga dale, një qeverim të mbështetun mbi mendjen e të barazuëm me mjetet. Duhet t'ia përmendi përher vehtes se ka një trashgim të keq nga kohnat e kaluëme. Qindra, mijra vjet të rrojtun tue përfitue nga "meratë e mëdhaja" në të cilat fati e ka pas pjestue. Ka përfitue nga rastet e mbara, nga ngjarjet e papritura. Por ka edhe humb dy të tretat e djemvet të saj gjatë këtyne përpjekjeve, shumë herë të çquëm për sakrificat që kan kushtue, por edhe shumë herë të kota dhe damprurëse.

Besimi në vet-vehten asht gjysma e suksesit në jetë! Këtë besimin pa dyshim populli shqiptar e ka! Por nuk e zotnon si mbas nevojave të kohës sotme. Nuk mjafton të kujtosh se "je" dishka, për të patun sukses në jetën e sotme. Duhet t'a provosh me vepra krijuese, me pjekunin e mendjes, me zotsin e durimit, me masë e me drejtësi se "je" me të vërtet dishka!

Në se fati i mbar i joni prap do na shpëtojë nga rreziqet që na kanë rrethue, të kujtohemi për t'ardhmen: "shtamba vete shumë herë në kruë, por ma së fundi edhe thyhet"!

***(FAKSIMILE NGA MANUSKRIFTI
ORIGINAL)***



nach Ekrem Bey - München: 10. XI. 62:

$$1 \text{ Strem } = 993 \text{ m}^2$$

$$1 \text{ dynym} = 1040 \text{ m}^2$$

von Südbalkanien nach Griechenland gebracht um 1300
zuerst in Thessalien z. B. der Lofia (?)

$$1 \frac{1}{3} \text{ stremë} = 1 \text{ pend ge'}$$

$$7 \text{ stremë} = 1 \text{ ditë purë.}$$

nach Nexhmedin Vrioni: Mai 63

$$\text{dynym (mir)} 888 \text{ m}^2 \quad 60 \text{ vija miri me } 60 \text{ vi}$$

$$\text{Verken } 1776 \text{ m}^2 \quad 120 \times 120 \text{ vija miri ose lehe}$$

$$1 \text{ olitë miri} = 2 \text{ verken } \frac{1}{2}$$

$$1 \text{ dynym i aktuelar zyrtarisht në Shqipëri pas } 7924 = 1000 \text{ m}^2$$

B I S E D I M E

M B I

"HISTORIN BUJQËSORE TË SHQIPNIS "

Zoti Ministër,

P E R M B A J T J A

- Parathënje: Letër Ministrit t'Ekonomisë Kombëtare.
- Kapt. I. Përshkrimi i fushës bregdetare të Shqipërisë.
- Kapt. II. Historija bujqësore e kësaj toke.
Perioda e I-rë: Koha e lashtë:
prej 160 para Kr. deri më 1250 pas Kr.
Perioda e II-të: Koha e Mesme:
prej 1250 pas Kr. deri më 1835 pas Kr.
Mënyra e zotimit dhe e përdorimit tokës nën sundimin
e Perandoris Otomane.
Perioda e III-të: Koha e Ré:
prej 1835 pas Kr. deri më 1912.
- Kapt. III. a) Origjini dhe historija e disa pasunive tokësore në Shqipëri.
b) Gjendja e sotme e bujqësisë.
- Kapt. IV. Mjetet për t'a përmirësuar.
- Kapt. V. Përfundim: një shikim në të ardhmen.

- 183 -

në dam të përgjithshëm, dhe pa asnjë dobi për kërkënd!

Uroj që nga këto ngjarje të na rujë Zoti; uroj që me një Shqipni etnikisht dhe ekonomikisht të bashkueme, dëshirat e krahut, të vllaznohen me të drejtat e kapitalit, për me sigurue nevojat e bukës të vendit t'onë, dhe uroj që ky problemi të zgjidhet, me kënaqsin e përgjithshme. Por, në rrethanat edhe ma të mbara, uroj që të mbretnojë mbi gjithë pasjonet në Shqipni, arsyeja dhe masa në çdo veprim! Mëkambja ekonomike e një vendit, të varfën dhe të pazhvilluëm, si asht ky i jonë, nuk duron tronditje, nuk duron shtërngata ase shpejtime. Mos të harrojmë, se kanë qenë pikërisht nevojat ekonomike që kemi pasun, e që kanë rrjedhun nga padija e jonë, nga dëshira e shpejtimit të zhvillimit t'onë, nga megalomanija e jonë, që na kanë shpëtërrue shpirtënisht dhe na kanë varfnue materjalisht. Dhe ma së fundi, i kanë pregadit e i kanë çelë rrugën hymjes së të huajvet! Por këta, dihet, nuk vijnë pse i duën fort shqiptarët, dhe nuk gabohen dot ma, prej mendjehollsis s'onë në interesat e tyre. Mos t'a bjem me të tilla gabime prap popullin shqiptar në atë pikë sa që të thotë "kemi qenë mirë, kur kemi qenë keq".

Brumi i jonë, i pakët ase i shumë, si do që asht, duhet të mjaftojë për nevojat t'ona. Se këto nevojat nuk i dikton "dëshira", por i dikton "mundësia" e jonë. Shpresat, llogarit, të mbështetuna në mëshirën, ase në nevojën e botës për neve, kanë dalë dhe do dalin përherë të rrema. Prej vet-vedit duhet të kërkojë populli shqiptar, të shërojë pas kësaj plagët, që rrethanat e kalueme i kanë shkaktrue. Në do t'a fitoj e t'a rujë të drejtën që të rroj i pamvarun nga fqinjët e tij, duhet ma


./.

- 184 -

para të japi provat e zotsisë tija në këtë pamvarsin me vepra paqsore,
ekonomike, përparimtare. Me punën e tij, me ndershmënin reale, duhet t'i
vejë masën e kësaj liris e të rregulloj, dalë nga dalë një qeverim të
mbështetun mbi mendjen e të barasurë me mjetet, Duhet t'ia përmendi për-
herë vehtes, se ka një trashgim të keq nga kohnat e kalueme. Qindra,
mijra vjet ka rrojtun, tue përfitue nga "meratë e mëdhaja", në të cilat
fati e ka pas pjestue. Ka përfitue nga rastet e mbara, nga ngjarjet e
paprituna. Por ka edhe humb ~~saka~~ dy të tretat e djemvet të saj, gjatë
këtyne përpjekjeve, shumë herë të qqueme për sakrificat që kan kush tue,
por edhe shumë herë të kota dhe dampruese.

Besimi në vet-vehten asht gjysma e suksesit në jetë! Këtë
besimin pa dyshim populli Shqiptar e ka! Por nuk e zoton si mbas nevoja-
vet kohës sotme. Nuk mjafton të kujtosh ~~se~~ se "je" diçka, për të patun
sukses në jetën e sotme. Duhet t'a provosh me vepra krijuëse; me pjekunin
e mendjes, me zotsin e durimit, me masë e me drejtësi! Se "je" me të
vërtetë diçka!

Në se, fati i mbar i joni, prap do na shpëtojë nga rreziqet
që na kanë rrethue, të kujtohem për t'ardhmen: "shtamba vete shumë herë
në kruë, por ma së fundi edhe thyhet"!






ANEKS II ~ Pasqyra e disa pasunive toksores ~
 ~ ndërmjet të kohës 1900-1912 dhe ndryshimi ~
 ~ i tyre deri sot 1944 ~


Emri i personit që qarkesh = zotuesi = pasunis, por që nuk është vetësenjor	Vendi ku gjendet pasunia	Sasia e vlerave të tokës monet pasun.	Pjestar në 1900	Sot në 1944	Të drejtë. Pjesat e tyre të gjatës. n. Sot. ndryshojnë si mbas të drejtës trashqimore
Omer Pasha Trioni	Berat Lushnje Fier	122.000	3	21	Figuron zyrtarisht ende e pande sado që pjestarët e ndryshëm zotërojnë vlerë pjesat e ndryshme. Ashtu prototipi i pasunive të kolektivizimit të famullare me gjithë reset e këti sistemi.
Aziz Pasha Trioni	Berat Lushnje	45.000	3	11	Ende pa pasur pa cennime, por në një pjesë të vogël trashqimi të trashq i një pasunive jashtë famullare vret 300.
Syreja bej Vlora	Vlonë Fier Lushnje	108.000	4	19	Kjo pasunia e nda në 1906 në 4 n shiten: pronarët të regjës vret 185 n trashqimi nga trashqimtar jashtë famullare " 185 qelantë të kësaj pjesë të regjës vret 190 sot pasurit për detyrë vobekët vret 190
Xhafer bej Vlora	Vlonë	21.000	1	4	n shiten pronarët jashtë famullare vret 20 n trashqimi nga trashqimtar jashtë famullare " 13.0
Brahusha Resuli	Lushnje	45.000	1	9	Pasuni kolektive famullare por në drejtësi me një pasun.
Mustafa B. Vokopola	"	28.000	3	6	Pasuni kolektive famullare por në drejtësi me një pasun.
Kahreman A. Cakrani	Berat Fier	40.000	1	9	Ende pa pasur pa cennime, por për disa pjesë të tokës a apli kësaj reformës nga regjës vret 7000
Abas A. Hamzari	Vlonë Fier	18.000	3	10	Nga kjo pasunia janë shiten një pjesë dhe pronarët të regjës vret. 4000
Adem B. Risilia	Vlonë Fier	22.000	3	14	Pasunia është e nda pa e pa cennime
Esad P. Toptani	Tiranë Krujë Durrës	46.000	1	0	Me vdekjen e Esad Pashës, një pjesë të qelantë të tokës a apli kësaj reformës nga regjës vret 5000 Tokat e tjera të regjës vret 5000 ashtu me regjës të posaçësisht
Xhelal P. Bushati	Shkodër Lezhë	32.000	1	1	Pasunia, gjatë kohës është sh tur disa pronarët dhe regjës dhe është zaptuar në pjesë të madhe për regjës.


ANEKS II. ~ Pasqyra e disa pasunive tokësore ~
~ ndërmjet të kohës 1900-1912 dhe ndryshimi ~
~ i tyre deri sot 1944 ~

Emri i personit që gëzesh - Zotuesi = Pasunisi, por që nuk është në vëllimin e pasunisë	Vendi ku gjendet pasunia	Sasia e vëllimit tokësor në pasuninë	Pjestar në 1900	Sot në 1944	Të rejtja. Pjesat nuk janë përgjithësisht Sot. Ndryshimi si mbas të drejtës trashgimore
Omer Pasha Trioni	Berat Lushnje Fier	122.000	3	21	Figuron zyrtarisht ende e pandan sado që pjestarët e ndryshëm zotëojnë në pjesat e ndryshme. Asht prototipi i pasunive kolektive famëljare me gjithë vëllimin e këtyre sistemeve.
Aziz Pasha Trioni	Berat Lushnje	45.000	3	11	Ende me por e pa cennueme vëllim në një pjesë të vogël trashgimi të trashgimis e një personit jashtë famëljare vëllim 3000
Syreja bej Vlora	Vlonë Fier Lushnje	108.000	4	19	Kjo pasunia e kësaj me 1906 u bë pjesë në shpëtim, pronarët të vegjël: vëllim 18.500 në trashgimi nga trashgimtar jashtë famëljare " 18.500 që kanë bërë të përkohshme gjatë borxheve për detyrë vobekit Vëllim 19.000
Xhafer bej Vlora	Vlonë	21.000	1	4	Në shpëtim pronarët jashtë famëljare vëllim 3.000 në trashgimi nga trashgimtar jashtë famëljare " 13.000
Brahusha A. Resuli	Lushnje	45.000	1	9	Pasunia kolektive famëljare por nën drejtimin e një personi.
Mustafa B. Vokopola	"	28.000	3	6	Për më 600 vëllim që janë ende zotë të një pjestarit, gjithë toka hater asht shpëtim bujqërit dhe pronarët të vegjël vëllim 4000
Sahremhan A. Cakrani	Berat Fier	40.000	1	9	Ende me por e pa cennueme, përveç për disa pjesa të kësaj asht kësaj referime asht që shkaktojnë kësaj e vëllim 7000
Hasa A. Hamzaraj	Vlonë Fier	18.000	3	10	Nga kjo pasunia janë shpëtim bujqërit dhe pronarët të vegjël vëllim 4000
Idem B. Risitia	Vlonë Fier	22.000	3	14	Pasunia asht e ndanë por e pa cennueme
Isad P. Toptani	Tiranë Krujë Durrës	46.000	1	0	Me ndërkohë Isad Pashës, një pjesë të vogël që ja kishin të shpëtim, vëllim 5000 e kësaj pronarët bujqërit të ndryshëm. Tokat e kësaj në shpëtim nga ana e shpëtim me ligj të posatskëve
Xhelal P. Bushati	Shkodër Lesh	32.000	1	1	Pasunia, gjatë kohës asht shpëtim tur disa pronarët dhe bujqërit asht asht zotëues të pjesë ma të madhe prej bujqërit.

Hasan A. Hamzaraj	Fier	18.000	1	9	per disa pjesa me 2000 vjet referuar agrot e shkaktot kumfje e vjet 7000
Abas A. Hamzaraj	Vlonë Fier	18.000	3	10	Nga kjo pasuria janë shpërndarë bujqet dhe pronarët të vegjël vet. 4000
Adem B. Risilia	Vlonë Fier	22.000	3	14	Pasuria asht e ndanë për e paccunime
Esad P. Toptani	Tiranë Krujë Durrës	46.000	1	0	Me ndekjen Ead Pashës, një pjesë të vogël që ja kishin të shqetësi, vet 5000 dhe pronarë bujq të ndryshëm. Tokat e tjera u shpërndanë nga ana e ashtet me ligji të posaçshëm
Xhelal P. Bushati	Shkodër Lezhë	32.000	1	1	Pasuria, gjat kohës asht shpërndarë tur disa pronarët dhe bujqet dhe asht zaptuar në pjesën më të madhe prej bujqet.
Milet Shalvani	Durrës	40.000	1	1	Pasuria asht dhënë me gëra shoqëris. E. I. A. A për 25 vjet.
Abdi B. Toptani	Tiranë Durrës Krujë	58.000	6	14	Pasuria u nda, me 3 pjesë me para. gushtitë bujqet, pronarët dhe me të fundit shoqëris. E. I. A. A gjithësisht 38.000 vjet.
Demir P. Bonoti (Pegiu)	Durrës Pegiu Kavaj	45.000	1	9	Nga kjo pasuria janë shpërndarë pronarët të vegjël dhe shoqëris Ital-Alb, me 18.000 vjet.
Dervish B. Bigaku	Elbasan Lushnjë	50.000	3	4	Pasuria u nda me para me 8 pjesë. Një pjesë shiti 250 vjet. Tokat e tjera janë të paccunime partë ndanë
Riza B. Libohova	Gjithëkrahë Fier Lushnjë Janinë	98.000	1	7	Nga kjo pasuria kanë mbetur gjithësej me 2000 vjet të paccunime të fundit me 20.000 vjet. Janë të ndanë me qullësisht gjithë tokat e tjera janë shpërndarë Pronarët janë të njësuar.
Tuad B. Toptani	Krujë Tiranë	53.000	7	20	Nga kjo pasuria me të për te gjurmë u shpërndarë të vegjël dhe E. I. A. A-s. mbetur në ndanë me paccunime dhe në njësi







INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE E KULTURORE TË
SHQIPTARËVE – SHKUP
ALBANISCHES INSTITUT - ST. GALLEN

Eqrem Bej Vlora
BISEDIME MBI “HISTORIN BUJQËSORE TË SHQIPNIS”

Përgatitën për botim:
Albert RAMAJ
Skender ASANI

Redaktor teknik: Naser Fera
Përgjegjës i botimit: Sevdail Demiri
Shtypi: Focus Print – Shkup
Tirazhi: 500 copë

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски

631.4(496.5)(091)

RAMAJ, Albert

Eqrem Bej Vlora : bisedime mbi “Historin bujqësore të shqipnis” /
përgatitën për botim Albert Ramaj, Skender Asani. - Shkup : Instituti i
trashëgimisë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve, 2021. - 336 стр.; 25 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4897-49-1

1. Asani, Skender [автор]
а) Земјоделско земјиште -- Историја -- Албанија

COBISS.MK-ID 55902213